

Si bëhet ankesa kundër një vendimi të Entit Federal për Migracion?

Keni marrë përgjegjje negative prej Entit Federal për Migracion (BFM)?

Drejtohuni menjëherë te avokatët ose këshillimoret në afërsinë tuaj, nëse dëshironi të këshilloheni ose të shkruani një ankesë. Por veproni me kohë, sepse gjatë kohës së vazhdimit të afatit të procedurës ankesore mund të ju arrestojnë. Nëse nuk mund të organizoni këshillim juridik por duhet të veproni menjëherë, atëherë ju ndihmon ky udhëzim. Ky udhëzim është përpiluar nga zyra zvicerane për ndihmë të refugjatëve - SFH, një Organizatë Joqeveritare, e cila angazhohet për të drejtat e refugjatëve dhe të azilkërkuesve (www.osar.ch). Lexoni këtë udhëzim me kujdes dhe ndiqni saktësisht udhëzimet.

1. Çka duhet të dini

→ Ju mund të bëni vetëm një ankesë

Përgjegjës për shqyrtimin e ankesës suaj është Gjykata Federale administrative. Është Gjykata më e lartë në procedurën e azilit dhe vendimi i saj është përfundimtar. Adresa është si vijon:

[Bundesverwaltungsgericht](http://www.bundesverwaltungsgericht.ch)

Postfach, CH-9023 St. Gallen

Telefon +41 (0)58 705 26 26, Fax +41 (0)58 705 29 80

→ mos të ju kaloj afati i ankesës

Shikoni informacionin me titull «këshillat mbi mjetët juridike» («Rechtsmittelbelehrung/voies de droit») në faqën e fundit të vendimit. Aty shihni ju sa kohë keni për të bërë ankesën. Ka vendime të dryshme, dy prej tyre janë:

1. Kërkesa juaj për azil është **refuzue**. Ju duhet që ankesën tuaj ta dorëzoni më së voni **30 ditë** pasi që e keni marr vendimin. Të dielat, të shtunat dhe ditët e festave llogariten.
2. Në kërkesën tuaj **nuk është ndërhy**, dmth. ajo është vlerësue si e pabazë ose si e keqpërdorur. Me këtë rast ju duhet që brenda **pesë ditësh pune** ta dorëzoni ankesën. Të dielat, të shtunët dhe ditët e festave nuk llogariten. Kujdes nga dërgimi mbrapa në ndonjë shtet tjetër evropian. Ankesa nuk ka ndonjë ndikim të madh në mos largimin e juaj..

Për të mos humbur kohë, më së miri është që t'a dërgoni ankesën me fax, e pastaj origjinalin e dërgoni me postë.

2. Porositja e dosjeve

Do t'a keni më lehtë për t'a aryetuar ankesën tuaj, nëse i keni të gjitha dokumentet të cilat ju duhen, dokumente në të cilat është i bazuar vendimi i Entit Federal. Pprandaj porositni sa më shpejt të jetë e mundur aktët e kërkesës suaj për azil në Entin Federal për Migracion (BFM / ODM), nëse këtë se keni marr automatikisht.

Përdorni formularin **A**. Shkruani drjetpëdrejti në formular, aty ku e shihni këtë ✍ shenjë.

→ **Plotësoni formularin pikë për pikë:**

- 1** Shënimet personale dhe adresa aktuale e banimit (mbiemri, emri, ditëlindjet e të gjithë personave, të cilët janë të prekur prej vendimit të Entit Federal për Migracion, rruga, numri i postës dhe vendëbanimi)

- 2** Vendi, data

- 3** N-Nummer (këtë numër gjashtëshifror e gjeni në pjesën e epërme, të majtë, të vendimit të Entit Federal për Migracion)

- 4** Data e vendimit të Entit Federal për Migracion (e gjeni në pjesën e epërme, të majtë, të vendimit të Entit Federal për Migracion)

- 5** Nënshkruani këtu.

- 6** Dërgoni formularin rekomandë në adresën e Entit Federal për Migracion. Bundesamt für Migration, Quellenweg 6, 3003 Bern-Wabern.

Pas pak ditësh do të ju vijnë kopjet e procesverbaleve të intervistave si dhe dosje tjera. Në raste normale nuk duhet të paguani asgjë për një shërbim të tillë.

3. Përgaditni ankesën

→ **A përkraheni nga Enti Social?**

Nëse po, atëherë kërkoni nga Enti Social një vërtetim. Këtë vërtetim ia bashkangjitni ankesës. Edhe nëse vërtetimin e merrni pas kalimit të afatit, atëherë dërgojeni vërtetimin sa më shpejtë që është e mundur.

→ **Dikush duhet t'ua përkthej vendimin e Entit Federal për Migraciont.**

Mbani mend argumentet e Entit Federal për Migracion, të cilat kan qar deri te refuzimi i kërkesës suaj për azil. Gjatë shkruarjes së ankesës duhet që të jipni mendimin tuaj në lidhje më këto argumente.

→ **Organizoni dëshmitë.**

Ju duhet që së bashku me ankesën të dërgoni të gjitha dëshmitë që keni e që në rastin tuaj do të ju hyjnë në punë. Pra dëshmi të cilat ende nuk i keni dorëzuar autoriteteve zvicerane (p.sh. vërtetime të mjekut, fletëarrestime, vendime gjyqesh etj.). Organizoni me kohë të gjitha dokumentat e nevojshme.

4. Filloni të shkruani ankesën

Një ankesë mund t'a shkruani në gjermanisht, frengjisht ose italisht. Ndoshta e njifni dikend që mund të ju ndihmoj gjatë shkruarjes së ankesës. Në vijim gjeni formularët disafaqësh **B** (shembull), se si shkruhet një ankesë. Lutjet, kërkesat më të rëndësishme janë të shkruara më parë. **Ju duhet t'a plotësoni Formularin dhe t'ia përshtatni situatës suaj personale.**

Shkruani drejtpërsëdrejti në formularët e përgaditur, aty ku gjeni shenjën ✍. Përdorni fleta plotësuese nëse formularët nuk ju mjaftojnë.

→ **Plotësoni Formularët e ankesës B, pikë për pikë:**

- 7** Vendi, data

- 8** Të dhënat personale dhe adresa e tashme e banimit (mbiemri, emri, ditëlindjet e të gjithë personave, të cilët janë përmendur në vendimin e Entit Federal për Migracion, rruga, numri i postës dhe vendëbanimi)

- 9** Data e vendimit të Entit Federal për Migracion (e gjeni në pjesën e epërme të majtë, të vendimit të Entit Federal për Migracion)

- 10** N-Nummer (këtë numër gjashtëshifror e gjeni në pjesën e epërme, të majtë, të vendimit të Entit Federal për Migracion)

11 Kjo është **pjesa më e rëndësishme e ankesës**. Arsyetoni gjerësisht, pse nuk pajtoheni me vendimin e Entit Federal për Migracion, dhe pse dëshironi të qëndroni në Zvicër. Nëse formularët nuk ju mjaftojnë, atëherë përdorni fleta plotësuese. Keni kujdes:

- Konfrontohuni me të gjitha argumentet e Entit Federal për Migracion.
- Nëse vendimi i Entit Federal për Migracion arsyetohet me atë se deklaratimet tuaja nuk janë të besueshme? - atëherë shkruani të gjitha kundërgjithësitë dhe mundohuni që çdo kundërgjithësi ose keqkuptim të mundshëm t'a sqaroni.
- Çka do të ju ndodhte nëse do të ishit të tani të ktheheni në vendlindjen tuaj? Sqaroni se kush, kur, pse dhe si ju ndjekë.
- Ndjekja duhet të dëshmohet, apo së paku tregohet në mënyrë të besueshme. Bashkangjitni të gjitha dëshmitë të cilat ende nuk i keni dorëzuar, (p.sh. fletëarrestime, vërtetime të mjekut, vendime gjyqesh, artikuj gazetash etj.) dhe sqaroni domethënien e tyre.

Shtesë tek ankesat me vetëm 5 ditë pune afat:

- Në qoftë se nuk i dorëzoni dokumentet e juaj të udhëtimit apo të identifikimit, tregoni arsyen e saktë për këtë gjë.
- Në qoftë se në rastin e juaj, autoritetet do shtronin edhe ca pyetje konkrete plotësuese, i shkruani disa (p.sh. për ndonjë ndodhi të caktuar, për gjendjen politike në qytetin e juaj).
- Në qoftë se Entit federal për migracion – BFM dëshiron të ju kthen në ndonjë shtet tjetër ku ju keni qenë më parë i tregoni arsyet se pse kjo nuk guxon të ndodhë (p.sh.: se keni frikë se ai shtet tjetër mund të ju dëbon drejtë për së drejti në vendlindjen e juaj. Ju keni anëtarë të ngushtë të familjes në Zvicër etj.).

Dërgimi prapa në ndonjë shtet evropian, Norvegji apo Islandë; KUJDES ankesa nuk ka ndonjë ndikim të madh në mos largimin e juaj:

Kjo do të thotë se ju do të dëboheni edhe përkundër paraqitjes së ankesës. Kjo ndodh zakonisht në ato raste kur shteti tjetër evropian ku ju keni qenë më parë është pajtuar të ju pranon përsëri. Kërkoni që të vërtetohet përsëri « Ndikimi mbi dëbimin » e kërkesës. Shpjegoni se pse keni frikë që ky shtet evropian nuk do ta shqyrton mirë rastin e juaj apo pse në vendlindjen e juaj ju kanoset rreziku nga trajtimi degradues dhe jo njerëzor.

Sipas ligjit të Zvicrës refugjatët mund të marrin azil:

Neni 3 i Ligjit të Azilit

«Refugjat janë personët të cilët vendlindjen e tyre, apo në vendin në të cilin kanë jetuar së voni, ndiqen për shkak të rasës, fesë, përkatësisë kombëtare, përkatësisë së një shtrese të caktuar shoqërore ose për shkak të bindjeve politike, iu janë nënshtruar dëmeve serioze, ose kanë frikë të arsyeshme se mund të ju nënshtrohen dëmeve të tilla.

Si dëme serioze vlejnë në radhë të parë rrezikimi i trupit, i jetës ose i lirisë, si dhe masat të cilat shkaktojnë shtypje (presion) të padurueshme psikike. Duhet pasur kujdes për arsyet specifike të ikjes të femrat.»

12 Po nuk pranoheni si refugjat, mund të merrni **lejen e përkohshme të qëndrimit (leja F), nëse dëbimi juaj nga Zvicra nuk është i mundur**. Dëbimi juaj nga Zvicra nuk është i mundur nëse nuk do të ishte njerëzore që t'ju këthejn në atdheun tuaj. Një rast i tillë do të ishte i dhënë sikur p.sh. ju do të ishit **konkretisht i rrezikuar** në vendlindjen tuaj nga ndonjë arsye tjetër nga ato të cilat i keni deklaruar.

Sqaroni këtu të gjitha arsyet tjera, përveq arsyeve të deklaruara më parë, të cilat në rastin tuaj flasin kundër kthimit në vendë lindjen tuaj. Disa shembuj:

- Zbatimi i vendimit për largimin nga Zvicra është i pamundur për shkak të arsyeve mjeksore **shëndetësore**, nëse mjekimi i ndonjë sëmurje të rëndë mund të bëhet vetëm në Zvicër. Sqaroni se qfarë pasoja do të kishte largimi i juaj nga Zvicra dhe bashkangjitni një vërtetim aktual të Mjekut. Kërkoni që Gjykata Federale për Ankesa të marrë mendim (ekspertizën) mjeksore.
- Nëse në vendin nga i cili vini mbretëron **luftë qytetare ose situatë e dhunës së përgjithshme**. Sqaroni se qfarë pasojash do të kisht ju në rastë të kthimit.
- Enti federal për Migracion shpesh argumenton se ekziston mundësia për **arratisje, strehim intern**, d.m.th. se mund të qëndroni në një vendë tjetër në shtetin prej nga vini, aty ku nuk jeni të kërcënuar, rrezikuar. Mirëpo ndoshta për ju është një gjë e tillë e pamundur!
Argumente që vijojnë mund të luajn rol të madh:
 - Ju nuk mund të mbijetoni një vend të tillë për *arsye Ekonomike* (p.sh. se për shkak të shkollimit tuaj, gjuhës ose situatës aktuale e cila mbretëron aty etj., nuk mundeni të gjeni punë)
 - Ju nuk keni *lidhje të ngushta* me vendin ku strhohuni (p. sh. ju nuk keni jetuar atje kurrë, ose vetëm një kohë të shkurtër, nuk e flisni gjuhën që flitet aty, apo nuk keni të afërm apo të njohur etj.)
 - Ju nuk mund të qëndroni aty për shkak të moshës suaj, gjinisë ose pse keni një familje shumë të madhe.

13 Në faqen e fundit i shkruani të gjitha dëshmitë që i'a bashkangjitni ankesës. Dërgoni origjinalet, ndërsa kopjet ndalni për vete. Poashtu duhet të dërgoni edhe një kopje të vendimit të Entit Federal për Migracion. Bashkangjitni edhe vërtetimin e Entit Social, nëse merrni ndihma Sociale. **Tani kopjoni ankesën dy herë.**

14 Nënshkruani të tre egzemplarët. **Dy egzemplar** me të gjitha dëshmitë (kopjen e vendimit të Entit Federal për Migracion, vërtetimin e mvarësisë Sociale dhe dëshmitë e tjera) i dërgoni rekomandë në adresën që vijon: Bundesverwaltungsgericht, Postfach, 9023 St. Gallen. Keni kujdes afatët!

5. Çka ndodhë më tutje?

Ju do të merrni postë prej Gjykses Federale. Dikush duhet të ju përkthej përmbajtjen dhe nëse është e nevojshme reagoni. Egzistojnë mundësi të ndryshme. Në vijim disa nga mundësitë më të rëndësishme:

- Ju merrni nga një **vërtetim** për arritjen e dosjes suaj. Deri në vendimin përfundimtar mund të qëndroni legalisht në Zvicër. Vendimi i këtillë mund ndodh brenda pak ditësh.
- Gjykata Federale e vlerëson ankesën tuaj "**prej fillimit të pashpresë**", atëherë kërkohet një **parapagim** i shpenzimeve dhe ju cakton afatin për bërjen e pagesës. Nëse nuk paguani, atëherë nuk shqyrtohet ankesa fare. Nëse paguani, atëherë kërkesa juaj do të shqyrtohet, por shansat për sukses janë veçanërisht **të vogla**.
- Gjykatës Federale ju cakton një afat të shkurtër për përmirësimin e mangësive të ankesës që keni bërë. Ju duhet që patjetër të reagoni. Përndryshe ankesa e juaj nuk shqyrtohet fare.
- Gjykata Federale ju jep mundësin e dhënjes së mendimit tuaj në lidhje me mendimin e ri të Entit Federal për Migracion. Mundohuni të reagoni.

Vendimi i Gjykatës Federale mund të jetë i ndryshëm. Nëse ai është negativ, atëherë jeni të detyruar t'a lëshoni Zvicrën. Gjykata Federale mundet që rastin t'a dërgoj Entit Federal për Migration për rishqyrtim. Vendimi mund të jetë pozitiv dhe ju merrni azil në Zvicër ose pranoheni përkohësisht.

Vendimi Gjykses Federale ndaj kërkesës tuaj sipas rregullave është përfundimtar. Ankesa të tjera në Gjykatën Federale janë të papranushme. Në raste specifike është e mundur të dërgohet një Ankesë rishqyrtuese apo siq quhet një Revizion.

Informohuni te Këshillmoret Juridike: <http://www.fluechtlingshilfe.ch/hilfe/nuetzliche-adressen>.